



Datë: 14.04.2026

A.nr.134/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.134/2026, të datës 04.02.2026, të parashtruar nga ankuesit F.Z, S.P, N.H, A.R, Nj.A, E.S, N.A, E.M, I.H, B.D, Sh.L, F.M-M, F.Gj-K, N.D, R.K, S.S-B, M.M, Sh.H, H.Rr, B.M, M.G, M.M, G.R, A.Z, V.N-P, B.K, A.B, B.F, F.S, B.A, A.Q, D.B, I.H, F.D, T.K-L, E.Sh, N.Q, V.S, A.Zh, S.A-L, V.S, H.L, O.B, I.M-K, V.G-K, B.L-Xh, I.H, S.A-M, D.R, Rr.Z, A.G-C, A.O, F.B, M.Gj, B.S, B.G, L.T, L.J, A.S, V.P, J.K, F.U, A.P, L.B, L.D, A.K, H.S-L, I.M-B, B.A, F.U, F.Z-M, I.P, A.B dhe A.G, të cilët me autorizim të përbashkët, i përfaqëson ankuesi F.Z, kundër organit të punësimit: Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 14.04.2026, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.134/2026, e datës 04.02.2026, e parashtruar nga ankuesit F.Z, S.P, N.H, A.R, Nj.A, E.S, N.A, E.M, I.H, B.D, Sh.L, F.M-M, F.Gj-K, N.D, R.K, S.S-B, M.M, Sh.H, H.Rr, B.M, M.G, M.M, G.R, A.Z, V.N-P, B.K, A.B, B.F, F.S, B.A, A.Q, D.B, I.H, F.D, T.K-L, E.Sh, N.Q, V.S, A.Zh, S.A-L, V.S, H.L, O.B, I.M-K, V.G-K, B.L-Xh, I.H, S.A-M, D.R, Rr.Z, A.G-C, A.O, F.B, M.Gj, B.S, B.G, L.T, L.J, A.S, V.P, J.K, F.U, A.P, L.B, L.D, A.K, H.S-L, I.M-B, B.A, F.U, F.Z-M, I.P, A.B dhe A.G.

A r s y e t i m

Ankuesit si në preambulë të këtij vendimi më datë 04.02.2026 kanë parashtruar ankesë në KPMSHCK kundër Përgjigjes të datës 27.01.2026, të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me pretendimin mbi të drejtën e kompensimit të përvojës së punës nga 0.25% në 0.5%, nga koha kur ka hy në fuqi Ligji i Pagave në Sektorin Publik dhe në vazhdimësi nga 0.5%.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Zhvillimit Rajonal, ndërsa, kjo e fundit, ka dërguar përgjigjen në pretendimet ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 596/2026 të datës 04.02.2026, e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 02.02.2026; Përgjigjen në kërkesë e datës 27.01.2025 të Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së; Kërkesën e datës 22.01.2026 të ankuesve e parashtruar tek Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së; Akt Emërimet e ankuesve; Kopjen e ID-së së ankuesve; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 09.02.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 13.02.2026 dhe 19.02.2026.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesve është e pabazuar, *sepse:*

Gjendja e fateve të çështjes

Nga shqyrtimi i provave të administruara rezulton se ankuesit janë të punësuar në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe së të njëjtit kanë statusin e nëpunësit civil. Rrjedhimisht, ankuesi F. Z, sipas Akt Emërimit Nr.1458/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Udhëheqës i Departamentit për Brime Njerëzore*; ankuesja S.P, sipas Akt Emërimit Nr.1459/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Udhëheqëse e Departamentit për Buxhet dhe Financa*; ankuesja A.R-SH, sipas Akt Emërimit Nr. 1439/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtare Ligjore*; ankuesja Nj.A, sipas Akt Emërimit të datës 08.01.2026, mbanë pozitën *Zyrtare e Lartë për Buxhet dhe të Hyra*; ankuesja E.S, sipas Akt Emërimit Nr. 1472/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtare për Financa*; ankuesi N.A, sipas Akt Emërimit Nr.1424/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtar i Teknologjisë Informative*; ankuesja E.M, sipas Akt Emërimit Nr.1446/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtare e Lartë Ligjore*, ankuesi I.H, sipas Akt Emërimit Nr.2072/2024 të datës 21.10.2024, mbanë pozitën *Zyrtar i Lartë për Pasuri*; ankuesi B.D, sipas Akt Emërimit Nr.1590/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Udhëheqës i Njësisë së Auditimit të Brendshëm*; ankuesja Sh.L sipas Akt Emërimit Nr. 1471/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtar Certifikues*, ankuesja F.M-M, sipas Akt Emërimit Nr. 1470/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtare Certifikuese*, ankuesja F.Gj-K sipas Akt Emërimit me Nr. 1443/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtare për Përkthim Shqipe anglisht dhe anasjelltas*, ankuesja N.D sipas Akt Emërimit Nr. 1466/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Udhëheqëse e Divizionit për Përkthim dhe Lekturim*; ankuesja R.K sipas Akt Emërimit Nr. 1444/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtare për Përkthim Shqip Serbisht dhe Anasjelltas*; ankuesja S.S-B sipas Akt Emërimit Nr. 2066/2024 të datës 08.10.2024, mbanë pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Përfaqësim Ligjor*; ankuesja M.M sipas Akt Emërimit Nr.2122/2024 të datës 01.04.2025, mbanë pozitën *Lektore*, ankuesja Sh.H, sipas Akt Emërimit Nr.1464/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Udhëheqëse e Divizionit për Arkivim*; ankuesi H.Rr sipas Akt Emërimit Nr. 1471/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtar për Financa*; ankuesja B.M, sipas Akt Emërimit Nr. 1442/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtare Ligjore*; ankuesja M.G, sipas Akt Emërimit Nr. 1430/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtare për Arkivim*; ankuesja M.M, sipas Akt Emërimit Nr. 1417/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtare e Lartë e Burimeve Njerëzore*; ankuesja G.R, sipas Akt Emërimit Nr. 1419/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtare e Lartë e Burimeve Njerëzore*; ankuesi A.Z, sipas Akt Emërimit Nr. 1420/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtar i Lartë i Burimeve Njerëzore*; ankuesja V.N-P, sipas Akt Emërimit me Nr. 1463/2024 të datës

01.08.2024, mbanë pozitën *Udhëheqëse e Divizionit për Paga dhe Shërbime të Prokurorëve*; ankuesi B.K, sipas Akt Emërimit Nr. 1451/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Koordinator i Komisioneve të Përherhshme të KPK*; ankuesi A.B, sipas Akt Emërimit Nr.2107/2025 të datës 22.01.2025, mbanë pozitën *Udhëheqës i Departamentit për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshme*, ankuesi B.F, sipas Akt Emërimit Nr. 1457/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Administrator i Lartë i TI-së për Baza të të Dhënave* ankuesi F.S, sipas Akt Emërimit Nr. 1461/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Siguri dhe Transport*; ankuesi B.A, sipas Akt Emërimit Nr. 2123/2025 të datës 01.04.2025, mbanë pozitën *Zyrtar për Logjistikë*; ankuesi A.Q, sipas Akt Emërimit Nr.1465/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Logjistikë dhe Mirëmbajtje*; ankuesja D.B, sipas Akt Emërimit Nr. 1438/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtare Ligjore*; ankuesi I.H, sipas Akt Emërimit Nr. 1447/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtar për Logjistikë*; ankuesja T.K-L, sipas Akt Emërimit Nr. 1428/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtare e Lartë për Prokurim*; ankuesja N.Q, sipas Akt Emërimit Nr. 1462/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Udhëheqëse e Divizionit për Financa*; ankuesja V.S, sipas Akt Emërimit Nr. 1418/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtare e Burimeve Njerëzore për Paga*; ankuesja B.L-Xh sipas Akt Emërimit Nr. 1461/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Udhëheqëse e Divizionit për Staf Administrativ*; ankuesi A.Z,h sipas Akt Emërimit Nr. 1431/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtar i Lartë për Shpenzime*, ankuesi N.H, sipas Akt Emërimit me Nr. 1460/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Udhëheqës i Departamentit për Teknologji Informativë*; ankuesja F.D, sipas Akt Emërimit Nr.2200/2026 të datës 13.01.2026, mbanë pozitën *Udhëheqëse e Njesisë për Prokurim*, ankuesja E.Sh, sipas Akt Emërimit me Nr. 1429/2024 të datës 01.08.2024 mbanë pozitën *Zyrtare e Lartë për Prokurim*; ankuesja V.S, sipas Akt Emërimit Nr. 1433/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtare për të Hyra*; ankuesja S.A-L, sipas Akt Emërimit Nr. 1425/2024 të datës 01.08.2024 mbanë pozitën *Zyrtare e Lartë e Burimeve Njerëzore*; ankuesi H.L, sipas Akt Emërimit me Nr. 1450/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtar i Lartë për Komunikim Publik*; ankuesi O.B ,sipas Akt Emërimit Nr.1445/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtar për Përkthim Shqip-Serbisht dhe anasjelltas*; ankuesja I.M-K, sipas Akt Emërimit Nr. 1435/2024 të datës 01.08.202, mbanë pozitën *Zyrtare e Lartë për Mbështetje të Paneleve Hetimore*; ankuesja V.G-K, sipas Akt Emërimit Nr. 1436/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtare e Lartë për Mbështetje të Paneleve Hetimore*; ankuesi I.H, sipas Akt Emërimit Nr. 1469/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Sisteme Elektronike*; ankuesja S.A-M, sipas Akt Emërimit Nr. 1421/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Analiste e Lartë e Sistemit*; ankuesi D.R, sipas Akt Emërimit Nr. 1422/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Analist i Lartë i Sistemit*; ankuesi Rr.Z, sipas Akt Emërimit Nr. 1420/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Administrator i Lartë i TI-së për Sisteme*; ankuesja A.G-C, sipas Akt Emërimit Nr. 1423/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Administrator i Lartë i TI-së për Rrjetin Shtetërorë*; ankuesi A.O, sipas Akt Emërimit Nr. 1454/2024 të datës 01.08.202, mbanë pozitën *Administrator i Lartë i TI-së për Sisteme*; ankuesi F.B, sipas Akt Emërimit Nr.1468/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Infrastrukturë*; ankuesja M.Gj, sipas Akt Emërimit Nr.2098/2024 të datës 13.12.2024, mbanë pozitën *Udhëheqëse e Njesisë për Integritet Evropian dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare*; ankuesi B.S, sipas Akt Emërimit Nr.2152/2025 të datës 22.05.2025; mbanë pozitën *Administrator i Lartë i TI-së për Baza të të Dhënave*; ankuesi B.G, sipas Akt Emërimit Nr.2111/2025 të datës 13.03.2025, mbanë pozitën *Udhëheqës i Njesisë për Komunikim Publik në SKPK*; ankuesja L.T, sipas Akt Emërimit Nr. 1432/2024 të datës 01.08.2024; mbanë pozitën *Zyrtare e Lartë për Financa*; ankuesi L.J ,sipas Akt Emërimit me Nr.1453/2024 të datës 01.08.2024,

mbanë pozitën *Zyrtar për Operativë dhe Siguri*; ankuesi A.S ,sipas Akt Emërimit me Nr. 1446/2024 të datës 01.08.2024; mbanë pozitën *Zyrtar i Depos*, ankuesja V.P, sipas Akt Emërimit me Nr. 1455/2024 të datës 01.08.2024; mbanë pozitën *Administrator i Lartë për Siguri*; ankuesi J.K, sipas Akt Emërimit Nr. 1452/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtar për Transport*; ankuesi F.U, sipas Akt Emërimit Nr.2070/2024 të datës 21.10.2024, mbanë pozitën *Zyrtar për Logjistikë*; ankuesi A.P, sipas Akt Emërimit Nr.2134/2025 të datës 01.04.2025, mbanë pozitën *Zyrtar për Transport*, ankuesi L.B, sipas Akt Emërimit Nr.2071/2024 të datës 21.10.2024, mbanë pozitën *Zyrtar për Pranim të Mallit*; ankuesja L.D, sipas Akt Emërimit me Nr. 1437/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtare e Lartë Ligjore*; ankuesja A.K, sipas Kontratës së Marrëdhënies së punës të datës 15.12.2023, mbanë pozitën *Drejtori i Njësisë për Shqyrtimin e Performcës së Prokurorisë*; ankuesja H.S-L, sipas Akt Emërimit Nr.1567/2024 të datës 01.08.2024; mbanë pozitën *Zyrtare për Hulumtim*; ankuesja I.M-B, sipas Akt Emërimit Nr.2095/2024 të datës 10.12.2024, mbanë pozitën *Udhëheqëse e Zyrës për Verifikim Prokurorial*; ankuesja B.A, sipas Akt Emërimit Nr. 1561/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtare për Vlerësim Profesionale dhe Verifikim në NJSHPP*; ankuesja F.U, sipas Akt Emërimit me Nr.1563/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtare e Lartë për Statistika në NJSHPP*; ankuesja F.Z, sipas Akt Emërimit Nr. 1564/2024 të datës 01.08.2024; mbanë pozitën *Zyrtare e Lartë për Statistikë në NJSHPP*; ankuesja I.P, sipas Akt Emërimit të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtare e Lartë për Baza të të Dhënave në NJSHPP*, ankuesja A.B, sipas Akt Emërimit Nr. 2080/2024 të datës 11.11.2024, mbanë pozitën *Koordinatorë e Zyrës për Trajnime* dhe ankuesi A.G, sipas Akt Emërimit Nr.2063/2024 të datës 23.09.2024 mbanë pozitën *Udhëheqës i Zyrës për Trajnime dhe Zhvillim*.

Ankuesit përmes përfaqësuesit të tyre të përbashkët, më datë 22.01.2026, i janë drejtuar më kërkesë Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, për kompensimin e përvojës së punës nga 0.25% në 0.5% nga hyja në fuqi e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, ndërsa, ky i fundit më datë 27.01.2025, përmes përgjigjes në kërkesë me Nr.105/2026, ka njoftuar ankuesit se kërkesa e tyre e datës 22.01.2026 është refuzuar.

Pretendimet ankimore

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendojnë se punëdhënësi nuk ka përmbushur obligimin sipas dispozitave të nenit 6 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. Shtojnë se e drejta e kompensimit të shtesës së përvojës së punës nga 0.25% në 0.5%, nga koha kur ka hy në fuqi Ligji i Pagave në Sektorin Publikë është e drejtë që rrjedhë sipas Aktgjykimit për rastin nr. KO79/23, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Kërkojnë që ankesa të aprovohet, të njihet e drejta e përvojës së punës më 0/5% sipas ligjit dhe të kompensohen në mënyrë retroaktive sipas vlerës së dëmit për përvojën e punës nga 0.25% në 0.5% nga koha kur ka hyrë në fuqi Ligji i Pagave në Sektorin Publik.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Lidhur me pretendimin e ankuesve referuar kompensimit lidhur më përvojën e punës, Kolegji i Këshillit iu referua nenit 6, paragrafi 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me të cilin është përcaktuar se: “6. Paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës, në masën: 6.1. zero pikë njëzetë e pesë

për qind (0.25%) për çdo vit të plotë pune, deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë; dhe 6.2. zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune, mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë”, dispozita këto të cilat i janë nënshtruar vlerësimit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese, më ç’rast, kjo e fundit, me Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, gjegjësisht në paragrafin II të dispozitivit ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndërsa, në pjesën arsyetues gjegjësisht në pikën 380 dhe pikën 381 të këtij aktgjykimi ka sqaruar: 380. Gjykata ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) dhe paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht me të drejtën në gëzimin paqësor të pronës dhe barazinë para ligjit. Kjo, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, ndër të tjera, sepse (i) zbritja joproporcionale e nivelit të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Kosovës është në kundërshtim të plotë me parimet kushtetuese, ligjore, parimet relevante ndërkombëtare dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe përtej cenimit të të drejtave respektive individuale, rezulton edhe në cenim të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe vlerave të Republikës së Kosovës;...ndërsa (v) përgjysmimi i shtesës për përvojën e punës për të gjithë kategorinë e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para të përvojës së punës, kufizon të drejtat dhe liritë themelore të tyre, pa asnjë qëllim legjitim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 të Kushtetutës. 381. Thënë këtë, sipas sqarimeve të dhëna më sipër ndërlidhur dhe me efektin e Aktgjykimeve të Gjykatës, kjo e fundit (i) nuk do të shfuqizojë paragrafin 6 të nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit të kontestuar, ndërsa (ii) do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. 382 Kjo sepse, lidhur me paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar që ndërlidhet me shtesën mbi pagën për përvojën e punës, Ligji i kontestuar në paragrafin 1 të nenit 45 të tij, ka shfuqizuar edhe Ligjin nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, i cili përfshin nenin 18 (Shtesa mbi pagën për përvojën e punës) sipas të cilit, për çdo vit të përvojës së punës të kaluar në shërbimin civil dhe jashtë tij, përveç përvojës së kaluar në punë praktike, nëpunësit civil sipas këtij ligji i takon e drejta shtesë në pagën bazë prej zero pikë pesë për qind (0,5%). Shpallja e pavlefshme e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar i kombinuar me faktin që Ligji nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë shfuqizohet gjithashtu përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar, do të rezultonte në zbrazëti ligjore, përkitazi më të drejtën për shtesa mbi pagën për përvojën e punës. Për pasojë, duke balancuar parimin e sigurisë juridike dhe të drejtat dhe liritë themelore, Gjykata do të lë në fuqi paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në periudhën prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, duke i përcaktuar detyrimin Kuvendit, që brenda kësaj periudhe të ndryshojë dhe/ose plotësojë paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në pajtim me konstatimet e këtij Aktgjykimi. Në ndryshimin dhe/ose plotësimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, Kuvendi duhet të ketë parasysh që efektet e ndryshimit/plotësimit të tij në kontekst të lartësisë së shtesës për përvojën e punës burojnë që nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi”.

Andaj, duke qenë se Kuvendi i Kosovës brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese nuk ka bërë plotësim/ndryshimin e nenit 6, paragrafi 6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Këshilli në mungesë të këtij rregullimi ligjor, nuk ka juridiksion ligjor që të detyroj institucionet publike të bëjnë kompensimin e përvojës së punës për zyrtarët publikë vetëm mbi bazën e aktgjykimit kushtetues dhe rrjedhimisht, pretendimet ankimor mbi rrethanat ekzistuese nuk kanë mbështetje ligjore.

Theksuar si më sipër, Kolegji bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.134/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesve F.Z;
- Sekretariatit të Këshillit Prokurorial: Drejtorit të Përgjithshëm dhe Njësisë së Burimeve Njerëzore; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.